



## **Shkolla fillore dhe e mesme e ulët „Skënderbeu“ K r a i s h t ë Historiku i shkurtër i shkollës**

Puna edukativo arsimore në shkollën tonë daton që nga viti 1927 dhe kjo është bërë në bazë të një kërkesë të bërë nga qytetaret e fshatit Kraishtë në organet e arsimit të asaj kohe. Kështu me vendimin Nr:67136 të datës 14 shtator të vitit 1927 hapet shkolla para katër-klasëshe në fshatin Kraishtë. Mësimet i vijonin nxënësit e fshatit Kraishtë dhe Varigoc. Sipas shënimeve që disponojmi në shkollë, mësimi kryesisht zhvillohej me përbërje fetare, mësimi zhvillohej në një shtëpi private, në vitin e parë shkollor 1927-1928 mësimet i kanë ndjekur 41 nxënës.

Kështu deri në vitin 1930 mësimi vazhdoi në shtëpi private, këtë vitë me vetë iniciativat e banorve të fshatit Kraishtë ndërtohet shkolla fillore me dy dhoma mësimi dhe një dhomë për banim të cilën e shfrytëzonte mësuesi i fshatit. Pas luftës së dytë botrore (1945) shkolla fillore në Kraishtë formohet si institucion i pa varur edukativo-arsimor katëtklasësh dhe emërohet Shkolla fillore “Kraishtë”. Tani mësimi zhvillohet në të dy gjuhët e mjedisit (në gjuhën shqip dhe serbishtë).

Mësues të parë të shkollës sonë në gjuhën shqipe ishin Sadik Luma-Prishtina dhe Halil Zenun Bajraktari (Iballje Shqipëri Perfektura e Kukësit. Migjeni ishte kryemësues i Sadikut dhe Halilit).

Në vitin 1950 për arsye të rrijës të numërit të nxënësve u ndie nevoja për lokal shkollor kështu prap banorët e fshatit Kraishtë më vetëkontribut ndërtuan shkollën e re me pesë dhoma të mësimi dhe lokale tjera përcjellëse kjo godin shkollore shfrytësohet edhe sot.

Në shtator të vitit 1958 si shumë shkolla tjera edhe shkolla jonë integrohet në gjirin e shkollës fillore të Lipjanit dhe atë si paralele e ndarë fizike. Me kalimin e kohës numri i nxënësve në shkollë tonë vinte gjithëni duke u rritur dhe kështu me 12 tetor 1967 paralelja deri dje fizike mvetësohet nga shkolla fillore e Lipjanit. Shkolla fillore në Kraishtë mvetësimin e vetë e fiton në bazë të ligjit mbi arsimin fillor i shpallur në gazetën zyrtare të Kosovës Nr, 2694\1.

Me propozimin e deputetit të Kuvendi Komunal të Lipjan zotri Faik Dedushit, Kuvendi në fjal merrë vendim që shkolla fillore në Kraishtë të pagëzohet me emrin e heroit tonë legjendar Gjergj Kastrioti “Skënderbeu”.

Në vitin shkollor 1967-68 shkolla fillore “Skënderbeu” kishte 468 nxënës që ishin të shpërndar në 16 paralele. Puna edukativo-arsimore në këtë vatrë të dituris nuk mungoi asnjëherë. Në shkollën tonë numri i nxënësve për çdo vitë rritej dhe kështu prap u ndie nevoja për dhoma mësimi dhe me 1980, në bashkëpunim me BVI-në e udhëhequr nga Fehmi Jupa, vendosi të ndërtoi një anekës prej tri mësojtore dhe një zyre për drejtorin.

Me iniciativën e drejtorit të shkollës Ahmet Dedushit dhe të organeve shkollore të datës 06.02.1981 Kuvendit të Komunës – BVI-së në Lipjan i është kërkuar që shkolla jonë të ketë bustin e Skënderbeut kërkesë që u realizua.

Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “Skënderbeu” në Kraishtë ka edhe një paralele të ndarë fizike pesë klasëshe në Varigoc, paralelja në fjalë është formuar në vitin shkollor 1985-86 me mësim të kombinuar. Mësues i parë në këtë paralele ishte Vehbi Kozhani. Mësimi zhvillohej në një shtëpi private të (Zeqir Zeqirit). Fshati Varigoc i futur thell në malet e Blinajës u dashtë të pres deri në vitin 2001 që edhe nxënësit e këti fshati ma në fund të gëzohen sepse tani nxënësit fituan një shkollë që me plot të drejtë e quajnë bukuroshja e fshatit kjo është dhurat nga Qeveria Japoneze.

Në janar të vitit 2011 nga drejtori i shkollës Ismet Dedushi është dorëzuar projekti ideor për ndërtimin e shkollës së re. Kjo kërkesë aprovohet nga DAK që në ngastrën kadastrale nr i njësisë: P-71409038-00601-0 prej 0.04,20 ha dhe oborr me sipërfaqe prej 0.22,25 ha (gjithsej 0.26.45 ha) të evidentuar mbi çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Ndërsa më 23.08.2011 filluen punimet për ndërtimin e shkollës së re. Në shtator të vitit 2015, 323 nxënës filluan të ndjekin mësimet në këtë shkollë.

Për shkaë të rrethanave të krijuara nga epidemia e përhapur Corona Virus me vendim të MASHT – DKA, mësimi është ndërprerë me date 11.03.2020

Me 23.03.2020 në bashëpunim me MASHT-in, DKA-n mësimi është realizuar me programin online. Kërkohej një angazhim i plotë i mësimëdhënësve duke krijuar mundësin që në këto rrethana egzistuese të zhvillohet mësimi përmes mësimëdhënësve, RTK-së dhe formave të ndryshme si Viber, Messenger dhe Zoom, te krijojmë mundësi për aktivizimin e rregullt të nxënësve që përmes këtyre programeve nxënësit të ndjekin mësimin.

Mësimëdhënësit sipas orarit të caktuar komunikuan me nxënës dhe prindër për të arritur rezultate. Mësimdhënësit kan krijuar protofole dhe angazhimet konkrete gjatë kësaj periudhe gjithashtu dëshmi të punës të cilat nënkuptojn angazhimet e tyre gjatë procesit mësimor.

Vërtetë është pëR tu vlersuar punën e mësimdhënësve për arritje të shpejtë që mundësoj mësimin formal nëpërmjet internetit. Ndihtes të madhe për nxënësit dhe mësimdhënësit është duke dhënë RTK-ja e cila në mas të madhe ka lehtësuar dhe ka mundësuar mësimin.

Me 25.09.2020, është bërë përrurimi i sallës sportive. Gjatë vitit 2021, Kryetari i Komunës z.Imri Ahmeti ka realizuar disa projekte në shkollë si: Paisja e bibliotekës me lektyra shkollore, Paisja e kabineteve biologjikimi-fizikë, sigurimi i 10 kompjuterëve për kabinetin e informatikës, 11 video projector, kaseta për vendosjen e librave për nxënës, vendosja e kamerave të sigurisë, rregullimi i parkingut për automjete etj.